

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Nëntor 2019

Tiranë, më 26 Dhjetor 2019:


Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Nëntor 2019, janë 693.951.

Krahasuar me Nëntor 2018, ky tregues rezulton me rritje 7,2 %. Në Nëntor 2019, hyrjet e shtetasve të huaj në vend janë 268.176. Krahasuar me Nëntor 2018, ky numër është rritur me 8,7 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë përgjatë njëmbëdhjetë muajve të vitit 2019 është 6.117.330, duke u rritur me 8,3 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2018. Në Nëntor 2019, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Spanja ka pasur rritjen më të madhe, ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur Maqedonia e Veriut.

Përgjatë njëmbëdhjetë muajve të vitit 2019, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Zvicra ka pasur rritjen më të madhe me 19,7 %, ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur Polonia me 14,0 %.

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Për publikim 26/12/2019

Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga vendi, gjatë muajit Nëntor 2019, janë 787.359 duke shënuar një rritje me 19,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Nëntor 2019, janë 480.176. Krahasuar me Nëntor 2018, ky numër është rritur 11,3 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Nëntor 2019, janë 307.183. Krahasuar me Nëntor 2018, ky numër është rritur 34,0 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë përgjatë njëmbëdhjetë muajve të vitit 2019, është 5.436.520, duke u rritur 9,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Nëntor 2018	Nëntor 2019	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Nëntor 2018	Janar- Nëntor 2019	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Gjithsej	647.126	693.951	7,2	10.413.320	11.206.071	7,6
Shqiptarë	400.448	425.775	6,3	4.767.216	5.088.741	6,7
Të Huaj	246.678	268.176	8,7	5.646.104	6.117.330	8,3
Dalje Gjithsej	660.514	787.359	19,2	10.777.106	11.397.031	5,8
Shqiptarë	431.279	480.176	11,3	4.969.039	5.436.520	9,4
Të Huaj	229.235	307.183	34,0	5.808.067	5.960.511	2,6

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Nëntor 2018	Nëntor 2019	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Nëntor 2018	Janar- Nëntor 2019	Ndryshimi vjetor (%)
Kosovë	68.902	74.340,0	7,9	2.013.887	2.171.329	7,8
Maqedonia e Veriut	37.273	22.120,0	-40,7	640.104	712.878	11,4
Greqi	39.670	41.433,0	4,4	498.435	539.915	8,3
Itali	20.322	23.700,0	16,6	407.719	435.956	6,9
Angli	8.923	7.032	-21,2	118.524	124.540	5,1
Mali i zi	31.378	30.965	-1,3	330.298	338.981	2,6
Poloni	490	732	49,4	153.263	131.767	-14,0
SHBA	4.543	4.842	6,6	112.900	114.765	1,7
Spanjë	433	922	112,9	24.044	28.167	17,1
Gjermani	3.198	4.433	38,6	137.396	161.575	17,6
Zvicër	1.180	1.304	10,5	51.911	62.120	19,7
Të tjera	30.366	56.353	85,6	1.157.623	1.295.337	11,9
Gjithsej	246.678	268.176	8,7	5.646.104	6.117.330	8,3

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Nëntor 2018	Nëntor 2019	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Nëntor 2018	Janar- Nëntor 2019	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	246.678	268.176	8,7	5.646.104	6.117.330	8,3
I. Personale	238.500	260.122	9,1	5.565.547	6.025.328	8,3
1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.	228.357	250.367	9,6	5.386.517	5.832.463	8,3
2. Trajtim shëndetësor	39	69	76,9	242	601	148,3
3. Qëllime fetare	50	39	-22,0	724	756	4,4
4. Udhëtarë transit	10.054	9.647	-4,0	178.064	191.508	7,6
II. Biznes dhe profesionale	8.178	8.054	-1,5	80.557	92.002	14,2

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Nëntor 2018	95.341	28.539	523.246	108.271	25.192	527.051
Nëntor 2019	109.518	33.764	550.669	124.614	31.762	630.983
Ndryshimi vjetor (%)	14,9	18,3	5,2	15,1	26,1	19,7
Janar- Nëntor 2018	1.352.896	743.679	8.316.745	1.379.697	768.910	8.628.499
Janar- Nëntor 2019	1.515.186	785.095	8.905.790	1.551.599	812.787	9.032.645
Ndryshimi vjetor (%)	12,0	5,6	7,1	12,5	5,7	4,7

Metodologji

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.;
2. Trajtim shëndetësor;
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> politika e revizionimit statistikor.

Diferencat statistikore misdis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 "Për Kontrollin Kufitar", neni 17 "Lehtësimi i verifikimeve Kufitare", ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.